



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:019351

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06484151

KE.nr. 1115/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit “Kompania e Sigurimeve Illyria” Sh.A me NUI 810483769 dhe seli ne sheshin Nene Terezë, nr.33, në Prishtinë, kundër të paditurit “Kompania e Sigurimeve Elsig” Sh.A me seli në rrugën Tringë Ismajli në Prishtinë, me objekt kontestues shpërblim i demit, jashtë seancës më 21 nëntor 2024, gjykata mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Konstatohet e tërhequr padia e paditësit “Kompania e Sigurimeve Illyria” Sh.A me NUI 810483769 kundër të paditurit “Kompania e Sigurimeve Elsig” Sh.A me seli në Prishtinë, për shkak të shpërblimit të demit.
- II. Secila e palë i bartë shpenzimet e veta procedurale në lidhje me këtë procedurë kontestimore.

ARSYETIM

Paditësi më 03.02.2021 ka ushtruar padi kundër të Paditurit, me të cilën i ka kërkuar kësaj gjykate të detyrohet i Padituri që në emër të borxhit t’ia paguaj shumën prej 667.39€ me kamatë ligjore prej 12% nga data 28.09.2020.

Megjithatë, Paditësi përmes parashtresës së datës 08.11.2024 e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë e paraqitur më datë 12.12.2019.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në bazë të nenit 3 para. 1 lidhur me nenin 261 të LPK-së vendosi si në arsyetim të këtij vendimit.

Gjykata Komeriale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1115/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.